



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 8921 Prot

Gjirokastër më 8 / 10 :2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 02.10 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 02.10 .2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 02.10 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:10 Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë. Mungojnë në mbledhje :Çabeli,,Feruni, E.Shehaj, Rova,Novi,Qeli., Lapaj,Nurçe, Koçollari, Binozi vijnë me vonesë Pandos, Mahmutaj Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes. Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

- 1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.09.2024.
 - 2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.09. 2024”.
 - 3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30.09. 2024”.
 - 4.P/Vendim “Për disa shtesa dhe pakësime në VKB nr. 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.
 - 5.P/Vendim për një ndryshim në VKB NR. 107, datë 14.12.2023 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave në bashkinë Gjirokastër për vitin 2024”
 - 6.P/Vendim” Për Miratimin në parim të Marrëveshjes së Binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Gjirokastër dhe Bashkisë Arcos De La Fontera (Spanjë)”.
 - 7.P/Vendim “ Për miratim të matërialit me objekt “ Nënshkrimi I marrëveshjes midis ASHK-SË dhe Bashkisë Gjirokastër”.
 - 8.P/Vendim “ Për miratimin e Komisionit të Strehimit për Programet Sociale të Strehimit
 - 9.P/Vendim “ Për miratimin e e procedurave për zbatimin e Programit Social të Strehimit “ Subvencioni I Kredisë2025”
 - 10.P/Vendim “ Për miratimin e e procedurave për zbatimin e Programit Social të Strehimit “ Subvencioni I Qirasë 2025”.
 - 11.Raport i punës së Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare për periudhën janar - qershor 2024.
 - 12.Të ndryshme.
- Znj Isaraj lexon dhe paraqet para këshillit 2 pikat shtesë të propozuara nga ekzekutivi.:

1.P/Vendim “ Për një ndryshim në VKB nr. 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

P/Vendim “Për vendosjen e z. Avni Mataj në shtëpinë e të moshuarve “ Shpresa e Jetës” Gjirokastër”

Z. Arianit Muho: Ky person është përjashtuar njëherë nga Shtëpia e të moshuarve Miratohet me 19 vota pro rendi i ditës së mbledhjes me dy pikat shitesë.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 04.09,2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-30.09. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-30. 09. 2024”, të cilat miratohen me 19 vota pro.

Kalohet te pika 4 e rendit të ditës e cila ka kaluar në Komisionin e Ekonomisë.

Nuk ka diskutime dhe miratohet me 20 vota pro dhe dy abstenime P/Vendim “Për disa shtesa dhe pakësime në VKB nr. 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

Znj. Isaraj paraqet pikën 5 të rendit të ditës. P/Vendim për një ndryshim në VKB NR. 107, datë 14.12.2023 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave në bashkinë Gjirokastër për vitin 2024”

Z. Llogo: Ne e kemi kaluar në Komisionin e Financave, por duam një qartësim për të gjithë këshilltarët.

Sqaron znj. Artiste Koko, drejtoreshë e Financës:

Si pjesë e grupit të punës me Burimet Njerëzore ju sqaroj se gjatë periudhës 2017-2024 Pushteti Qëndror ka nxjerrë disa VKM për mbështetjen e nëpunësit civil .

Vkm nr 503 ka prekur statusin e nëpunësit civil në 61 bashki të RSH, duke ndarë pjesën e aparatit të bashkive me funksionet e deleguara dhe pjesën e shërbimeve mbështetëse.

Është I njëjti document që ju kaloni dhe miratoni çdo fund viti për vitin pasardhës me përditësimin e bazës ligjore dhe në përputhje me VKM NR 503, datë 01.08.2024.

Z. Brahim: Doja të dija me sa % do të rriten pagat?Sa % I rritet paga punonjësit të komunaes që punon në shi e në diell? Për mua është një vendim I paqartë.

ZNJ. Koko: Absolutisht nuk ka abuzim , jemi në fazën ku përditësojmë bazën ligjore e cila do të jetë unike në 61 bashki. Nuk marrim vendim për strukturën , sepse është kompetebcë e kryetarit.

z. Brahim: Kur fillon rritja?

ZNJ. Koko: Jemi duke llogaritur kostot, shkon struktura në Ministrinë e Pushtetit Vendor, merr aprovimin dhe më tej fillon ristrukturimi.

Z. Brahim: Pse duhetta bini në këtë mbledhje?

Z. Llogo: Ky është një keqkuptim . Ne u sqaruam në Komision, por ne nuk kalojmë paga specifike, është e drejtë e ekzekutivit.

ZNJ. Isaraj : Është kuadër ligjor, për procedurë , struktura është kompetencë e kryetarit.

Z. Llogo: Jemi të qartë.

Z/Brahimi: Punëtor e komunaes pse nuk I kap kjo rritje?

Z. Aliko: Nuk jemi të qartë, nje document ku nuk është sjellë sa është kostua për buxhetin, çfarë impakti ka për buxhetin . Çdo bashki I përshtat pagat në lidhje me buxhetin që ka, nuk jemi kundër

rritjes së pagave sepse I dimë nevojat e punojnësve për paga, por donim një material më orientues të na vendosej në dispozicion.

Z. Hilaj: Ky është modeli tip në 61 bashki të vendit dhe ne duam të dimë sa do të jetë konkretisht midis minimale dhe maksimale. Kur fillon ndryshimi në pagë?

Znj. Koko: Ju vetë I keni miratuar në Këshill pagat për punonjësit e Shërbimeve Komunale dhe gjatë viteve 2021-2023 janë të vetmet paga që janë rritur dhe kakalear I njëjti vendim ku ndryshon baza ligjore nga VKM.328 në VKM 503.

15 ditë pas përfundimit të strukturës, pas konfirmimit nga Ministria e Pushtetit Vendor.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro dhe dy kundër , z. Aliko dhe znj. Cacaj..P/Vendim për një ndryshim në VKB NR. 107, datë 14.12.2023 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave në bashkinë Gjirokastrë për vitin 2024”

ZNJ. Isaraj; Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës.

.P/Vendim” Për Miratimin në parim të Marrëveshjes së Binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Gjirokastrë dhe Bashkisë Arcos De La Fontera (Spanjë)”. ZNJ. Kristina Gushi: Kjo është një marrëveshje në parim , me një qytet të UNESCO.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro.

Kalohet te pika 7 e rendit të ditës. P/Vendim “ Për miratim të matërialit me objekt “ Nënshkrimi I marrëveshjes midis ASHK-SË dhe Bashkisë Gjirokastrë”.

Z. Aliko: Nëse do të ketë fluks, a keni parashikuar punonjës shtesë dhe a do të jenë të gjithë nga bashkia?Z. Nebiaj: Pasi të marrim të dhënat, pasi të shikohet nr I dosjeve në vazhdim do të shikohet për punonjës shtesë.

Hidhet në votë pika 7 dhe miratohet me 21 vota pro.

Kalohet te pikat 8, 9 dhe 10 të rendit të ditës.

Z. Aliko: Sa kërkesa keni për strehim dhe bonus qeraje?Si keni menduar për të pastrehët? Do funksionojë me blerje banesash apo keni menduar të ndërtoni ?

Z. Nebiaj: Ështëpërcaktuar një sipërfaqe trualli në lagjen “ Zinxhira”, është punuar dhe ka përfunduar procesi I certifikimit të pronësisë dhe mendohen dy banesa massive.

Hidhe në votë dhe miratohen njëri psa tjetrit pikat 8, 9 dhe 10 të rendit të ditës me 21 vota pro.

Në lidhje raportin e punës për 6 mujorin e parë të vitit 2024 për Drejtorinë e Shërbimeve Komunale dhe Utilitare pas diskutimeve të shumta të z. Aliko për mungesën e preventivave në raport dhe të dhënave financiare dhe kërkesës së z. Brahimi për sqarime nga ana e Drejtorit u vendos që të merret në shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

Z. Brahimi: Të kihen parasysh rreth shkollave me pastrimin, me trafikun .

Të shikohet prerja e pishës te te farmacia , me rrugën e Plesatit çfarë është bërë?Me rrugën e Zhulatit?

Z. Llogo: E diskutuam dhe e lamë raportin për mbledhjen tjetër. Me dy gjëra jam dakord. Të kenë foto për ndërhyrjet dhe të ino për materialin që blihet.

Z. Nebiaj: Ju ngatërroni diçka që shërbimet komunale nuk bëjnë investime por shërbime në pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajte.

Kalohet te pika e parë shtesë në rendin e ditës P/Vendim “ Për një ndryshim në VKB nr. 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024”.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro

Pika e dytë shtesë:Z. Muho: Dokumentacioni është i saktë , por personi në fjalë është përjashtuar për veprime jo të hijshme para tre vjetësh? Akeni informacion për këtë gjë?

Do na hapi probleme.

Z. Aliko : Unë I besoj Arianitit dhe mendoj që të shikohet me kujdës. Unë mendoj të mos dërgohet.

ZNJ. Manxhari: Dosja është e plotë, ka dhe raportin sipas kërkesave të ligjit dhe edhe personat me probleme trajtoen dhe përmirësohen.

ZNJ. Isaraj : Drejtoria përkatëse e kapër detyrë monitorimin e mëtejshëm.

Hidhet në votë dhe miratohet me 18 vota pro:

P/Vendim “Për vendosjen e z. Avni Mataj në shtëpinë e të moshuarve “Shpresa e Jetës” Gjirokastër”.

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj

Sekretar
Etleva YZO



KRYETARI I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

